

Vendim nr. 246 datë 30.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 30.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (P) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PETRAQ DODI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 115, datë 22.07.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2025-253, datë 13.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin nr. 41-2021-328 (61/809 SP), datë 27.01.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 6, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 13, pika 2, 14, pika 4, 58, 187, 327, 328, pika 2, 329, pika 7, 329/a, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur një kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në bazë të të cilit, në datën 31.12.2018, ka regjistruar një procedim penal për veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (KP). Kërkuesi ka pretenduar në kallëzim se në vitin 2004 ka marrë një shumë parash hua nga shtetasi K.S., i cili që nga viti 1995 e deri në vitin 2016 ka qenë i punësuar në shtet dhe lekët që i ka dhënë atij hua i ka siguruar në mënyrë të jashtëligjshme, pasi nuk mund të sigurohej në atë kohë ajo vlerë të ardhurash me pagat që ai merrte.

2. Sipas kërkuesit, në datën 10.11.2004, ai ka marrë hua një shumë prej 16.700.000 lekësh nga shtetasi K.S., me qëllim privatizimin e një objekti. Pasi ka marrë këtë shumë, kërkuesi ka kryer privatizimin. Kërkuesi është paraqitur së bashku me shtetasin K.S. te zyra noteriale e noteres Zh.M. në datën 26.09.2008, ku ka nënshkruar një deklaratë noteriale, sipas së cilës ka bërë një marrëveshje verbale me shtetasen V.S., bashkëshorten e K.S., për të marrë hua shumën 25.000.000 lekë, të cilën do ta kthente pas një periudhe dyvjeçare, me një interes vjetor 12% për shumën totale të detyrimit. Pas periudhës dyvjeçare, nëse nuk do të ishte shlyer borxhi, do ta njihte bashkëpronare atë shtetase, në masën 50% në objektin e privatizuar. Në deklaratën noteriale është shënuar si detyrim shuma 25.000.000 lekë dhe jo shuma reale e detyrimit (16.700.000 lekë), pasi, sipas kërkuesit, kjo i është kërkuar si nder nga shtetasi K.S. Kjo deklaratë noteriale është vlerësuar si titull ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me kërkesën e shtetasit K.S., e cila, me vendimin nr. 41-2012-2144 (474), datë 03.05.2012, ka lëshuar një urdhër ekzekutimi.

3. Për kallëzimin, prokuroria ka arritur në përfundimin se nuk janë konsumuar elementet e anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i KP-së, pasi nuk ka rezultuar e provuar që shtetasit K.S. dhe V.S. të kenë qenë të përfshirë në veprimtari kriminale.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-328 (61/809 SP), datë 27.01.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes penale nr. 1506 të vitit 2018, për shkak se nuk provohet që të jetë kryer vepra penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 115, datë 22.07.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 41-2021-328 (61/809 SP), datë 27.01.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2025–253, datë 13.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 16.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

8.**Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

8.1. *Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:*

8.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, për shkak se Gjykata e Apelit Korçë ka shkelur kërkesat e ligjit për përbërjen e trupit gjykues, pasi, sipas neneve 13, pika 2, shkronja “d”, 14, pika 4 dhe 329, pika 7 të KPP-së, kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për krimet shqyrtohet në dhomën e këshillimit me trup gjykues të përbërë me një gjyqtar dhe jo me tre gjyqtarë, siç ka ndodhur në rastin objekt gjykimi.

8.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit*, pasi kërkuesi, në cilësinë e viktimës, nuk është njohur me të gjitha aktet dhe provat, në kuptim të nenit 58 të KPP-së. Moscilësimi i tij si viktimë është bërë *apriori* pa u mbështetur në ligj dhe në prova, pa analizuar ndonjë kusht ose kriter objektiv ligjor. Kjo duke mos marrë parasysh faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2012-2144 (474), datë 03.05.2012, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, duke konfiskuar pasuritë e

kërkuesit, ndaj plotësohen të gjitha kushtet e viktimës në këtë proces penal, e drejtë kjo e mohuar gjatë gjykimeve.

Marrja dhe administrimi i provave janë në kundërshtim me ligjin, pasi kërkesa e prokurorisë për pushimin e procedimit penal dhe vendimet përkatëse të gjykatave janë marrë në shkelje të procesit të rregullt ligjor. Pa u kryer një hetim i plotë, objektiv e profesional, në kushtet kur personi i kallëzuar zotëron pasuri ose të ardhura të shpërpjesëtuara në raport me nivelin e të ardhurave, apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme, të deklaruar ose të padeklaruar, dhe që nuk përlligjen prej tyre, si dhe pa kryer një akt ekspertimi financiar, arrijnë në përfundimin se nuk është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 287 i KP-së. Ky përfundim është subjektiv, i gabuar dhe nuk është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor. Organi i akuzës ka pasur tagrin të hetonte për çdo lloj vepre penale, të cilat nuk ishin objekt kallëzimi, hetimi ose gjykimi, por nuk e ka kryer këtë gjë. Gjithashtu, i kallëzuari, shtetasi K.S., ka marrë pjesë në gjykim pa marrë asnjë cilësi si subjekt i procedimit penal. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se nuk ka vend për njësimin e praktikës gjyqësore dhe duke injoruar pretendimet e kërkuesit ka arsyetuar në mënyrë të gabuar, për rrjedhojë ka zhvilluar kështu një proces haptazi të parregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal, të përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit, që ka vendosur për pushimin e vendimit të procedimit penal për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, me pretendimin se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për gjykim nga një gjykatë të caktuar me ligj, të standardit të arsyetimit të vendimit dhe aksesit, si dhe për marrjen dhe administrimin e provave duke mos kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka pasur pozicionin procedural të kallëzuesit në proceset gjyqësore ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

12. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024, nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

13. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit paraprak të çështjes, rezulton se procesi penal ka nisur pas kallëzimit të kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndaj shtetasit K.S. Prokuroria ka arritur në përfundimin se nuk konstatohen elemente të kësaj vepre penale, pasi nuk ka rezultuar e provuar që shtetasit K.S. dhe V.S. të jenë përfshirë në veprimtari kriminale. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-328 (61/809 SP), datë 27.01.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e çështjes penale. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 115, datë 22.07.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Sipas asaj gjykate, hetimet e kryera nga ana e organit procedues kanë qenë të plota dhe të drejtat e kërkuesit janë garantuar në përputhje me pozicionin procedural si kallëzues. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin

e rekursit të ushtruar nga kërkuesi, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së, si dhe ka konstatuar se pretendimi i tij për përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së apelit ka qenë në përputhje me legjislacionin procedural (neni 14 i KPP-së), të kohës kur është kryer shqyrtimi i çështjes.

14. Duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e çështjes, Kolegji do të analizojë se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkuesit mund të vihet në diskutim se është cenuar në rastin konkret, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur drejtpërdrejt atij.

15. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka nisur një procedim penal ndaj huadhënësit për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar në nenin 287 të KP-së. Kolegji, duke pasur parasysh interesin dhe qëllimin e kërkuesit, që është mbrojtja e pasurisë së tij, vlerëson se pavarësisht se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit gjyqësor, në thelb, e drejta substanciale që ai kërkon të mbrojtë është e drejta e pronës, e cenuar, sipas tij, si pasojë e urdhrat të ekzekutimit të lëshuar për shkak të moszbatimit të kontratës së huas, ku shuma e marrë kishte burim të ardhurash të paligjshme.

16. Duke u ndalur në rastin në fjalë, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se është person i dëmtuar si pasojë e kryerjes së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar në nenin 287 të KP-së. Kjo veprë penale nuk bën pjesë në ato vepra për të cilat KPP-ja parashikon se ndiqen me kallëzimin e personit të dëmtuar, por, në rastin konkret, ndjekja penale ushtrohet kryesisht nga prokuroria, e cila, sipas nenit 148, pika 1, të Kushtetutës, ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Kjo që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Për këtë arsye, Kolegji vëren se, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individi që pretendon se ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me atë proces penal.

17. Në rastin konkret, efekti ligjor i vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi është lënia në fuqi e vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale, për shkak se fakti i pretenduar për pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale nuk ekziston. Këto vendime nuk kanë sjellë dhe as mund të sjellin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës së kërkuesit, për të cilën ka pasur mundësi dhe mjetet juridike ta mbrojtë përmes procesit civil.

18. Për sa më lart, Kolegji vlerëson të theksojë se interesi substancial i kërkuesit për të mbrojtur të drejtën e pronës, rivendosja në vend e së cilës, në rastin konkret, nuk varet nga mënyra e përfundimit të procesit penal, objekt kundërshtimi. Edhe në rastin e një vendimi në favor, mjeti i përdorur nga kërkuesi nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes të së drejtës substanciale, për sa kohë nuk është i tillë që mund të rivendosë të drejtën e pretenduar të cenuar, pra të drejtën e pronës. Për të gjitha këto arsye, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione personae* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 30.09.2025